



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 131/2024

Prishtinë, më 25.4.2024, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Armend Muja, Driton Hyseni dhe Gramos Agusholli, anëtarë.

Munguan: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë

Pjesëmarrës tjerë: Tringa Dreshaj KDI; Gzim Mujaj EO; Sami Gashi dhe Salih Hoxha dhe GPLVV; dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura me datë 26.3.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;**
- 4. Shqyrtimi i Projektrezolutës për Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP, për vitin 2022;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Jeta Statovci, në cilësinë e kryesueses së grupit të punës, kërkoi të shtyhet shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, për konsultime shtesë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga deputetja Statovci.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 26.3.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 26.3.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektrezolutës për raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP, për vitin 2022

Kryetari theksoi se Komisioni në bazë të nenit 98 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 43 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive, në mbledhjen e mbajtur më 25.7.2023, e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP, për vitin 2022, dhe pas shqyrtimit të raportit financiar dhe të auditimit nga komisionet përkatëse, tani e procedon për Kuvend. Draftin e ka hartuar stafi i Komisionit, mbështetur në diskutimet e mëhershme dhe qëndrimet e komisioneve tjera, sipas procedurës, dhe nëse keni të shtoni apo ndryshoni diçka, urdhëroni.

Driton Hyseni, tha se draftrezoluta është e hartuar edhe në frymën e monitorimit të Ligjit për komunikime elektronike që e kemi bërë si Komision, ku dhe rekomandimet këtu janë në atë drejtim, që ARKEP-i ta rrisë performancën dhe të funksionojë sipas ligjit.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Projektrezoluta për raportin vjetor të ARKEP-it për vitin 2022 dhe procedohet tutje për seancë plenare.

4. Të ndryshme

Kryetari, tha se për javën e ardhshme, ministrja ka konfirmuar pjesëmarrjen për raportim, mirëpo, ende nuk ka sjellë raport me shkrim, siç jemi dakorduar, andaj, nëse nuk e sjellë, ju njoftoj se ajo pikë do të hiqet nga rendi i ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit